



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 510 Prot.

Durrës, më 07.02.2025

VENDIM

Nr. 05, datë 07.02.2025

"PËR MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes së bursave, për vitin akademik 2024 - 2025, për studentë të cilët vijnë në studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas tabelës përmbledhëse bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 140 studentë, efekti financiar 12,600,000 lekë.
2. Efekti financiar do të përllogaritet nga momenti i lindjes së të drejtës për përfitimin e bursës (plotësimi i kriterëve).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

